
	<p align="center"><b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosova –</b> <b>Republic of Kosovo</b></p> <p align="center"><b>Komuna e Prishtinës</b> Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

<b>Datë/a:</b>	12.04.2023.
<b>Për/ Za/ To:</b>	Operatori Ekonomik: "E-Commerce –Kosova" SH.P.K.
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Visar Shehu – U.D. i Departamentit të Prokurimit Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **11.04.2023 (11:04am)** të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "E-Commerce –Kosova" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor"**, me Nr. të Prok: **616-22-83-2-1-1** nxjerr:

## V E N D I M

- HUDHET POSHTË SI E PALEJUAR** kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: : "E-Commerce –Kosova" SH.P.K. e parashtruar me datë: 11.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor"**, me Nr. të Prok: **616-22-83-2-1-1**, kundër **Njoftimit për Kontratë**, të datës **28.09.2022** të publikuar ne web-faqe te KRPP-së , në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.
- Kërkesa për Rishqyrtim është në kundërshtim me nenin 108/A për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim – (afati 5 ditë para hapjes së ofertave deri në orarin zyrtar të punës 11:04am)
- Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin për të vazhduar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor"**, me Nr. të Prok: **616-22-83-2-1-1**
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>